



Phanuar / Dorezuar Primijsen/Prodato Received/Delivery	18.05.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMGHCK	2904/2022		1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.346/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.346/2022 të datës 08.04.2022 të parashtruar nga ankuesi _____ ne adresë rruga _____ në Komunën e _____ kundër Vendimit me Nr.KD/029 të datës 25.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 18.05.2022 mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.346/2022 e datës 08.04.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.KD/029 i datës 25.03.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e këtij vendimi duke bërë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me pikën II të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 20.09.2021 ka nxjerr vendim me Nr.01058 për formimin e Komisionit Hetimor për hetim të brendshëm administrativ lidhur me dyshimet e ngjarjes në Qendrën Korrektues për të Mitur në Lipjan për një ngacmim ndaj një të miture nga ana e një arsimtari të ndodhur më datës 17.06.2021.

Komisioni Hetimor më datë 02.11.2021 ka nxjerr Raport Përfundimtar të Hetimeve ku pas deklaratave të personave ka gjetur shkelje gjatë këtij procesi dhe ka rekomanduar Komisionin Disiplinor të ndër marr masat disiplinore në pajtim me ligjet në fuqi.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 20.01.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. KDM029 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"ndalim 20% e pagës për periudhën dy muaj dhe duke rekomanduar që ankuesi të largohet nga Koordinatori për arsim, kulturë dhe sport"*.

Ankuesi, kundër Vendimit me Nr.KDM029 të datës 20.01.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, fizikisht më datë 26.01.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:351/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 28.01.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Këshilli, me datë 18.02.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 02.03.2022 ka nxjerr Vendim A.nr.63/2022 me të cilin ka shfuqizuar Vendimin me Nr. KDM029 të datës 20.01.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 25.03.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. KD/029 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"ndalim 20% e pagës për përdhën një muaj dhe rekomandohet që të largohet nga koordinatori për arsim, kulturë dhe sport"*.

Ankuesi, kundër Vendimit me Nr.KD/029 të datës 25.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, fizikisht më datë 08.04.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:1964/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vendosjes meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 08.04.2022 me Nr. Prot:1964/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.KD/029 të datës 25.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin A.nr.63/2022 të datës 02.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit të datës 26.01.2022 me Nr. Prot:351/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.KDM029 të datës 20.01.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Njoftimin e datës 08.09.2021 nga Drejtori i QKF-Lipjan për Drejtorin e DTBM-së; Emailin e datës 08.09.2021 nga [redacted] Emailin e datës 08.09.2021 nga [redacted] për [redacted] dhe [redacted] Emailin e datës 24.09.2021 nga [redacted] për [redacted] Shkresë për hetimin me rastin e datës 17.06.2021 ku e mitura me masë edukative korrektues lajmëron zyrtaren sociale dhe udhëheqëse për ngacmim nga profesori i shkollës në QKML; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 28.01.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 18.02.2022; Kontrate pune për kohë të pacaktuar e datës 01.07.2018; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2021 dhe 2020; Raportin Përfundimtar i Hetimeve i datës 02.11.2021; Vendimin e datës 20.09.2021 për formimin e Komisionit Hetimor; Njoftimin e datës 16.10.2021 nga ankuesin për [redacted] dhe F.Mustafa; Njoftimin e datës 12.10.2021 nga [redacted] për ankuesin; Shënim Zyrtar i datës 18.06.2021; Deklaratë nga e mitura [redacted] Deklaratë e datës 18.06.2021 nga [redacted] Deklaratë e datës 18.06.2021 nga [redacted] Raporti javor i punës prej datës 11.06.2021 deri 17.06.2021; Raporti javor i punës i SHKK prej datës 11.06.2021 deri 18.06.2021; Formulari i regjistrit të lëvizjeve të burgosurve për SHKK datë 18.06.2021; Shkresë me mbishkrimin gjendja numerike javore e të burgosurve e datës 18.06.2021; Raportin e punës i Drejtorëve të Burgjeve; Emailin e datës 17.06.2021 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 12.10.2021 nga [redacted] ankuesi për [redacted] Emailin e datës 12.10.2021 nga [redacted] për ankuesin; Emailin e datës 12.10.2021 nga [redacted] për ankuesin; Dëftesë Nr.203318/314; Shkresë për personin e intervistuar [redacted] e datës 23.09.2021; Shkresë për personin e intervistuar [redacted] e datës 22.09.2021; Shkresë për personin e intervistuar [redacted] e datës 22.09.2021; Shkresë për personin e intervistuar [redacted] e datës 22.09.2021; Shkresë për personin e intervistuar [redacted] e datës 22.09.2021; Shkresë për personin e intervistuar [redacted] e datës 22.09.2021; Emailin e datës 19.10.2021, 04.10.2021 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 05.10.2021 nga [redacted] për [redacted] Forma për pushim e datës 18.06.2021; Fotografii.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e **bazuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Kontratës së Punës për kohë të Pacaktuar të datës 01.07.2018, ankuesi mbanë pozitën Zyrtar Korrektues në Qendrën Korrektuese në Lipjan, mirëpo i njëjti mban edhe pozitën Koordinator për Arsim, Sport dhe Kulturë në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, mirëpo sipas deklaratimit përmes emailit zyrtar të datës 24.02.2021 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës këtë pozitë e mban vetëm verbalisht nga drejtori i institucionit është caktuar ti kryej ato detyra.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.KD/029 të datës 25.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendon që Komisioni Disiplinor nuk ka vepruar sipas rekomandimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka tejkaluar kompetencën e tij për shkak që i është referuar dispozitave penale, duke mos arrit të konstatoj se cilat veprime nuk janë ndërmarr dhe cilat dispozita janë shkelur nga ana ime.

Dispozitat e nenit 5 paragrafi 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 15/2017 Planifikimi dhe Organizimi i Procesit Arsimor në Arsimin Parauniversitar për Personat e Provuar nga Liria në Institucionet Korrektuese, përcaktojnë që: *“4. Zyrtari përgjegjës i institucionit korrektues siguron dokumentacionin paraprak shkollor si dhe të dhëna të tjera të nevojshme për personat e privuar nga liria edhe të njëjtat ia ofron koordinatorit dhe drejtorit të shkollës amë. 5. Zyrtari përgjegjës i institucionit korrektues për çdo ndryshim që bëhet rreth lëvizjeve të nxënësve, kandidatëve të privuar nga liria (vajtje-ardhje) e njofton koordinatorin dhe drejtorin e shkollës amë”*, si rrjedhojë bazuar në këtë dispozitë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se nënkupton vetëm sigurimin e dokumentacionit paraprak shkollor për kandidatëve të privuar nga liria, në këtë rast Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.KDM029 të datës 25.03.2022 për rastin e ankuesit i është referuar këtyre dispozitave, në këtë rast Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se komisioni disiplinor gabimisht i është referuar dispozitave ligjore për rastin konkret, kështu edhe në bazë të Vendimit A.nr.63/2022 të datës 02.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka qenë i obliguar që të konstatoj saktë dispozitat ligjore në fuqi të cilat ankuesi i ka shkelur, mirëpo nuk ka arritur të konstatoj saktë një gjë të tillë.

Bazuar në komunikimet zyrtare që janë pjesë e provave të lëndës, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues përmes emailit të datës 08.09.2021 ka kërkuar dokumentacion lidhur me lidhur me këtë çështje, atëherë sipas emailit zyrtar të datës 08.09.2021 të dërguar nga Drejtori i Qendrës Korrektues për të Mitur, konstatohet se ka pasur komunikim mes ankuesit përmes telefoni me drejtorët e shkollave dhe

duke theksuar që nuk ka pasur shkëmbim të letrave por janë mbajtur vetëm takim të drejtpërdrejta me ta duke theksuar që ankuesi më datë 21.06.2021 është takuar me Drejtorin e Shkollës SHFMU Po ashtu pohon se e kemi rekomanduar DKA në Lipjan dhe Drejtorin e që mësimdhënësin të mos e dërgojnë në QKML por mundësisht atë t'a zëvendësojnë me ndonjë mësimdhënës tjetër, këtë e dëshmon edhe emaili i datës 24.12.2021 i dërguar nga ankuesi për Drejtorin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët ' " në Lipjan, po ashtu nuk kemi asnjë dëshmi në lëndë lidhur me përgjegjësit e Koordinatorit për Arsim,

Kulturë dhe Sport edhe pse kemi kërkuar vendimin për emërim të ankuesit në këtë pozitë, mirëpo në bazë të përgjigjes së datës 24.02.2022, na është konfirmuar që nuk ka vendim për këtë pozitë, andaj në mungesë të përshkimit të detyrave të punës për këtë pozitë, ka qenë e pamundur të vlerësohet saktë përgjegjësit që ka ankuesi, andaj Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të konstatoj këtë fakt, po ashtu Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, nuk ka dhënë asnjë nga arsyet e elementeve të përgjegjësisë disiplinore siç parashihet me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”* elemente këto që duhet plotësuar kumulativisht në mënyrë që të ekzistoj përgjegjësi disiplinore.

Gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit me Nr.KD/029 të datës 25.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.KD/029 të datës 25.03.2022, ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *“ndalim 20% e pagës për periudhën një muaj dhe rekomandohet që të largohet nga koordinatori për arsim, kulturë dhe sport”*, ndërsa Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht neni 50 paragrafi 5 përcakton se: *“Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore”*, si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni Disiplinor në këtë rast ka bërë shqiptimin e dy masave disiplinore për një shkelje, duke vepruar jashtë kompetencës së tij për këtë rast, dhe në kundërshtim me nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: *“1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore”*.

Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.KD/029 të datës 25.03.2022, në pjesën hyrëse të tij i është referuar edhe Kodit për të Mitur dhe Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke konstatuar që përgjegjësia e ankuesit përbënë përgjegjësi me elemente penale, në këtë kuptim, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konsideron që Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, nuk i ka dhënë kompetencë Komisionit Disiplinor të konstatoj që shkeljet eventuale të nëpunësve civil të trajtohen me elemente të procedurës penale.

Bazuar në të lartcekura, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, nuk ka arritur të vlerësoj drejtë gjendjen faktike dhe ka bërë konstatim të gabuar të normave juridike, duke mos vepruar as në pajtim me Vendimin A.nr.63/2022 e datës 02.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që Vendimi me Nr.KD/029 i datës 25.03.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës është nxjerr si rezultat i shkeljeve procedurale dhe si i tillë është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafët 1.2, 1.3, 1.4 dhe

1.5, të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për këtë pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Si u tha më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se obligohet Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi të bëjë kompensimin e ndalesës "ndalim i 20% i pagës për periudhën një muaj" dhe të bëjnë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me këtë vendim.

Meqenëse nga të lartcekurat është konstatuar që gjatë zhvillimit të kësaj procedure disiplinore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka gjetur që ka pasur shkelje procedurale, atëherë në këtë rast nuk është lëshuar në pretendimet për shkelje të supozuara nga ana e ankuesit.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"*, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *"Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit"*.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nën paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.346/2022, datë 18.05.2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- ❖ *Ankuesit*
- ❖ *Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;*
- ❖ *Udhëheqësit të Njesisë së Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;*
- ❖ *Arkivit të KPMSHCK- së.*